

**NDËRLIDHJA NË MES RESILIENCES, PERSONALITETIT DHE RREZIKUT
TË DJEGIES PROFESIONALE TEK PUNONJËSIT E POLICISË SË KOSOVËS**

**TEMA PËR TITULLIN
MASTER SHKENCOR NË PSIKOLOGJI KLINIKE DHE SHËNDETI**

NGA

NAZLIJE GËRVALLA



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË
PSIKOLOGJI KLINIKE DHE SHËNDETI
PRISHTINË**

KORRIK, 2021

REZYME

NDËRLIDHJA NË MES RESILIENCES, PERSONALITETIT DHE RREZIKUT TË DJEGIES PROFESIONALE TEK PUNONJËSIT E POLICISË SË KOSOVËS

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Aliriza Arënliu

Qëllimi i këtij hulumtimi është të shihet ndërlidhja mes personalitetit, resiliences dhe rrezikut të djegies profesionale tek punonjësit e Policisë së Kosovës.

Duke ditur se policia është një institucion mjaft i ndjeshëm dhe se punonjësit ballafaqohen në vazhdimësi me shkelës të ligjit, probleme nga më të ndryshmet përfshirë: rrahje, kacafytje, dhunë në familje, vrasje, lëndime e aksidente të rënda me fatalitet, kemi parë nevojën që të shohim se a ndikon personaliteti dhe niveli resiliencës së zyrtarit në rrezikun për djegie profesionale, dhe si ndërlidhen mes vete.

Gjatë hulumtimit dhe shfletimit të literaturës përkatëse në gjuhën shqipe kemi vërejtur se mungojnë studimet dhe hulumtimet për këtë popullatë mjaft të rëndësishme, e cila nuk duhet të lihet nën hije dhe pa një trajtim të mirëfilltë kur dihet se është një segment mjaft i rëndësishëm i shoqërisë sonë.

Për nga struktura punimin e kam ndarë në pesë kapituj. Punimi përmban pjesën hyrëse ku flitet për rrezikun e djegies profesionale tek punonjësit e policisë, kapitulli II përfshin hulumtimin e literaturës për resilienc, personalitetin dhe ndërlidhjen mes resiliences, personalitetit dhe djegies profesionale, hipotezat, kapitulli i III përmban metodologjinë e hulumtimit, kapitulli i IV përmban rezultatet e nxjerra nga hulumtimi si dhe kapitulli i V përfshinë diskutimin e rezultateve të nxjerra, përfundimet dhe rekomandimet.

Kapitulli i parë: në këtë kapitull kam përshkruar rrezikun i djegies profesionale tek punonjësit e policisë, disa nga hulumtimet që janë bërë, si dhe modelin e sindromës së djegies që është më i aplikueshëm në hulumtimet për djegien profesionale.

Në kapitullin e dytë: hulumtimi i literaturës kam dhënë konceptin e reziliences, hulumtimet e realizuara për resiliencën tek zyrtarët policor, personalitetin dhe djegien profesionale, ndërlidhja mes resiliencës, personalitetit dhe djegies profesionale, ku kam bërë një përshkrim të detajuar të

ndërlidhjes mes këtyre variablave, si dhe hulumtimet që janë bërë në këtë sferë.

Po ashtu kapitulli i dytë përmban edhe pyetjet kërkimore: A ekziston ndërlidhje në mes resiliencës dhe djegies profesionale në punë tek punonjësit e policisë?

A ekziston ndërlidhje në mes të hapjes ndaj përvojave, ndërgjeshmërisë, ekstraversionit dhe djegies profesionale në punë tek punonjësit e policisë?

Hipotezat: H – 1: Punonjësit e policisë që raportojnë nivele më të larta të reziliencës raportojnë nivele më të ulëta të djegies profesionale.

H – 2: Punonjësit e policisë që raportojnë nivele të larta në ekstraversion, hapje ndaj përvojave dhe ndërgjegjes raportojnë nivele të ulëta të djegies profesionale.

H – 3: Punonjësit e policisë që raportojnë nivele më të larta në neuroticizem raportojnë nivele më të larta të djegies profesionale.

Kapitulli i tretë: Metodologjia e hulumtimit- Hulumtimi është kuantitativ, një studim korrelacional dhe ndërseksional duke u përpjekur për të parë ndër lidhshmërinë mes personalitetit, reziliencës dhe rrezikut për djegie profesionale.

Përzgjedhja e mostrës është bërë në mënyrë të rastësishme. Pyetjet janë organizuar në shkallën e Likertit nga: fuqimisht nuk pajtohem (1), nuk pajtohem (2), neutral (3), pajtohem (4), fuqimisht pajtohem (5) për pyetëtorin e personalitetit dhe reziliencës, ndërsa për djegien profesionale: në një shkallë shumë të lartë(100), në një shkallë të lart (75), disi (50), në një shkallë të ultë (25) dhe në një shkallë shumë të ultë (0).

Ky hulumtim është realizuar në Divizionin për Operacione Drejtorinë Rajonale në Prishtinë. Në hulumtim kanë marrë pjesë 120 respondent zyrtarë të Policisë së Kosovës të punësuar në të gjitha njësitet e kësaj drejtorie. Në hulumtim kanë marrë pjesë 120 zyrtarë të Policisë së Kosovës Drejtoria Rajonale Prishtinë, të punësuar në të gjitha njësitë e kësaj drejtorie. Pjesëmarrësit në këtë hulumtim ishin të dy gjinive nga të cilët: femra n=31 apo 25.8% dhe meshkuj n=89 apo 74.2%. Moshë e pjesëmarrësve ishte nga 24 më e vogla deri në 62, me mesatare M = 39.6, DS = 9.59. Sipas gradës policore kemi: zyrtarë policor n=96 apo 80%, rreshter n=20 apo 16.7% dhe toger n=4 apo 3.3%. Me që kemi të bëjmë me një institucion mjaft të ndjeshëm sa i përket sigurisë dhe ruajtjes së të dhënave si dhe për të respektuar aspektin etik në hulumtime, fillimisht është marrë

miratimi nga Zyra për informim dhe marrëdhënie me publikun në Policinë e Kosovës për aplikimin e pyetësorëve.

Kapitulli i IV-të përmban analizën e të dhënave dhe rezultatet duke përfshirë: statistikat përshkruese si dhe analizat statistikore më rëndësi konkluduese. Rezultatet e studimit janë të paraqitura në mënyrë tabelore, histograme dhe përshkrimi narrativ i të gjeturave.

Kapitulli i V-të ka të bëjë me diskutimin e rezultateve të cilat janë analizuar, diskutuar në mënyrë kritike dhe analitike, duke i krahasuar ato me studime të ndryshme që janë shqyrtuar në pjesën e literaturës, por edhe duke shprehur qëndrimin e studiuesit në lidhje me to. Në këtë kapitull janë përfshirë gjithashtu edhe përfundimet e studimit dhe rekomandime përmes së cilave mendojmë që në të ardhmen mund të adresohet më mirë hulumtimi i djegies profesionale tek punonjësit e Policisë.